



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtina, 25 November 2013
Ref.No.:RK505/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI28/12

Parashtrues

Fehmi Ymeri

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. I. nr. 200/2010, të 10 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Fehmi Ymeri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Prishtinë. Në procedurën pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), parashtruesi përfaqësohet nga z. Habib Hashani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 10 janarit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 7 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 200/2010, ia kishte cenuar atij të drejtën e punës dhe të ushtrimit të profesionit, siç garantohet me dispozitat e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 mars 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 25 prill 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI28/12, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI28/12, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 22 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 10 qershor 2000, udhëheqësi i komisionit përzgjedhës e njoftoi parashtruesin se ai ishte përzgjedhur në pozitën e drejtorit të Ristrukturimit në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).
9. Në një datë të pacaktuar, Përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm e emëroi parashtruesin drejtor të Ristrukturimit në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) që nga 24 korriku 2000.
10. Më 16 shtator 2002, parashtruesi paraqiti njoftimin për dorëheqje, kryesisht për shkak të gjendjes së vështirë në të cilën po kalonte Korporata Energjetike e Kosovës.

11. Më 9 maj 2003, me vendimin ref. nr. 1579, drejtori menaxhues i KEK-ut e njoftoi parashtruesin se, që nga dorëheqja e tij nga pozita e drejtorit të Ristrukturimit, menaxhmenti i KEK-ut ishte përpjekur t'i gjejë atij vend të ri të përshtatshëm pune, por pa ndonjë sukses. Përveç kësaj, përmes kësaj letre, parashtruesi u njoftua se marrëdhënia e tij e punës me KEK-un përfundon më 10 gusht 2003.
12. Më 30 maj 2003, parashtruesi iu përgjigj drejtorit menaxhues të KEK-ut, ku ai e shprehte zhgënjimin e tij me vendimin, duke kërkuar anulimin e Vendimit 1579, të 9 majit 2003, lidhur me ndërprerjen e punësimit të tij.
13. Më 3 qershor 2006, drejtori menaxhues i KEK-ut kërkoj nga parashtruesi që ta respektojë Vendimin nr. 1579, të 9 majit 2003.
14. Më 20 maj 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin C1. Nr. 257/2008, e aprovoi padinë e parashtruesit dhe e anuloi Vendimin nr. 157, të 9 majit 2003, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe e urdhëroi KEK-un që ta kthejë parashtruesin në pozitën e tij të mëparshme. Gjykata theksoi se pas dorëheqjes së parashtruesit nga pozita e drejtorit të Ristrukturimit, punëdhënësi "ka qenë i obliguar t'i gjejë atij një pozitë adekuate brenda në KEK, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27.
15. Më 14 maj 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ac. Nr. 49/10, e refuzoi ankesën e KEK-ut dhe e vërtetoi vendimin e fundit të Gjykatës Komunale.
16. Më 10 janar 2010, Gjykata Supreme, me Vendimin Rev. I. no. 200/2010, e aprovoi revizionin e KEK-ut dhe e anuloi vendimin e instancave më të ulëta.
17. Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin e saj theksoi se "*gjykatat e shkallëve më të ulëta, bazuar në provat e administruara, i kanë zbatuar gabimisht dispozitat materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për të cilën arsye në pajtim me nenin 224.1 të Ligjit për procedurën kontestimore, revizioni i së paditurës u pranua dhe të dy aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta u ndryshuan dhe kërkesëpadia e paditësit u refuzua*".
18. Përveç kësaj, Gjykata Supreme theksoi se "*Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin themelor të punës, neni 11.1 pika b) parashihet se kontrata e punës shkëputet me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit. Akti i dorëheqjes së paditësit nga pozita e drejtorit të ristrukturimit është një mënyrë e shkëputjes së marrëdhënies së punës në pajtim me dispozitën e lartpërmendur. E paditura mund të ketë shprehur vullnet të mirë për ta caktuar paditësin në ndonjë pozitë tjetër të punës, por nuk ka qenë e obliguar. Ka qenë e drejtë e së paditurës që me rastin e dorëheqjes nga pozita me përgjegjësi të veçanta ta caktojë paditësin në ndonjë pozitë që iu përgjigjet aftësive të tij profesionale, për të cilën gjë e paditura ishte angazhuar, por nuk kishte pasur mundësi. Prandaj, vlerësimi i gjykatave të shkallëve më të ulëta se e paditura nuk e kishte zbatuar procedurën e shkëputjes së marrëdhënies së punës kundrejt paditësit për shkak të ndryshimeve ekonomike dhe në pajtim me nenin 12 të Rregullores nr. 2001/27,*

kjo nuk mund të pranohet nga Gjykata Supreme, pasi që në rastin e paditësit, marrëdhënia e punës i ishte shkëputur sipas nenit 11, paragrafi 1. pika b) e kësaj rregulloreje”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, për faktin se *“dorëheqja e tij kishte të bënte vetëm me pozitën e tij të caktuar si drejtor i ristrukturimit dhe jo me KEK-un”*. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se KEK-u ka qenë i obliguar t'i gjejë atij një vend tjetër të përshtatshëm pune brenda ndërmarrjes.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që parashikon:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar”.

23. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), të cilat pretendohen se janë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Pra, kjo gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Si përmbledhje, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë ashtu që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka paraqitur asnjë provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Gjykata Supreme i

ofroi parashtresit një aktgjykim të arsyetuar mirë lidhur me atë se përse punëdhënësi i tij nuk ishte i detyruar t'i gjente atij ndonjë vend tjetër të punës në KEK, pas dorëheqjes së tij nga detyra e tij e caktuar në këtë institucion.

26. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
27. Si përfundim, parashtresi i kërkesës nuk ka treguar se pse dhe si i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, rregullave 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Prof. dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

